

Bazuar në nenin 36, paragrafi 1, nënparagrafi 1.17, dhe nenin 65, paragrafët 1 dhe 2, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, të ndryshuar dhe plotësuar sipas Ligjit Nr. 05-L/150 dhe nenin 85 të Ligjit Nr. 04/L-093 për Banka, Institucione Mikrofinanciare dhe Institucione Financiare Jobankare, si dhe në zbatim të nenit 11 të Rregullores për Raportimin e Bankave, Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datë 10 qershor 2025, miratoi këtë:

UDHËZIM METODOLOGJIK
PËR RAPORTIMIN E TË DHËNAVE NË SISTEMIN E REGJISTRIT TË KREDIVE
TË KOSOVËS

91

Përmbajtja

Neni 1	4
Qëllimi dhe fushëveprimi	4
Neni 2	4
Udhëzime të përgjithshme.....	4
1. Përshkrimi i formatit të fajllave.....	4
1.1.1. Numri.....	4
1.1.2. Emri	4
1.1.3. Tipi i të dhënave	4
1.1.4. Kushti.....	4
1.1.5. Përshkrimi	5
2. Fajllat e pranueshëm.....	5
3. Refuzimi i fajllave	5
Neni 3	6
Struktura e fajllave	6
1. Fajlli i kredive	6
2. Fajlli i personave të lidhur.....	13
3. Fajlli i kolateralit	15
4. Fajlli i klasifikimeve.....	17
5. Fajlli i aplikacioneve në proces, të refuzuara dhe të aprovuara.....	18
6. Përditësimi i të dhënave në baza periodike	20
7. Fajlli i kredive	21
8. Fajlli i kolateraleve.....	22
9. Sqarime Shtesë	22
Neni 4	23
Shtojcat.....	23
Neni 5	23
Shfuqizimi	23
Neni 6	23
Hyrja në fuqi.....	23
Aneksset për fushat e përcaktuara të dhënave	24
Aneks I	24
Statusi ligjor i kredimarrësit	24
Aneks II	25
Lloji i entitetit juridik	25
Aneks III	26
Komunat.....	26
Aneks IV	28
Statusi martesor	28
Aneks V	29
Sektori Ekonomik.....	29

Aneks VI	30
Lloji i kredisë	30
Aneks VII	31
Periudha e kredisë	31
Aneks VIII	32
Mënyra e pagesës së kredisë.....	32
Aneks IX	33
Klasifikimi i kredisë	33
Aneks X	34
Qëllimi i kredisë.....	34
Aneks XI	35
Roli i personave të lidhur	35
Aneks XII	36
Lloji i kolateralit.....	36
Aneks XIII	37
Statusi i kredisë	37
Aneks XIV	38
Veprimi juridik.....	38
Aneks XV	39
Lista e shteteve	39
Aneks XVI	49
Madhësia e entitetit juridik.....	49
Aneks XVII	50
Përkrahja nga fondi	50
Aneks XVIII	51
Performanca e kredisë	51
Aneks XIX	52
Shtylla sipas SNRF 9.....	52
Aneks XX	53
Lloji i punëdhënësit.....	53
Aneks XXI	54
Lista e profesioneve.....	54
Aneks XXII	57
Arsyet e Refuzimit.....	57

Neni 1 Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është të përcaktoj mënyrën e raportimit të dhënave në sistemin e Regjistrimit të Kredive të Kosovës (tash e tutje RKK) nga ana e institucioneve kredidhënëse, të cilat të raportohen vetëm në formatin e specifikuar në këtë udhëzim.
2. Ky udhëzim zbatohet nga të gjitha institucionet kredidhënëse të licencuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës-(BQK).

Neni 2 Udhëzime të përgjithshme

1. Përshkrimi i formatit të fajllave

- 1.1. Përshkrimi i fushave që përmban fajlli i kredive, i personave të lidhur, i kolateralit si dhe fajlli i klasifikimit. Në vijim japim sqarime rreth tabelave të cilat paraqesin strukturën e fajllave për raportim. Secila tabelë (për secilin fajll që mund të raportohet në RKK) i përmban këto fusha (kolona):

1.1.1. Numri

Paraqet radhën e caktuar për secilën fushë në fajllin përkatës të raportimit (duke filluar me fushën e parë numër 1 nga ana e majtë).

1.1.2. Emri

Emri i caktuar për secilën fushë të dhënave.

1.1.3. Tipi i të dhënave

Përcakton tipin e të dhënave të çdo fushe. Tipi i të dhënave që përmbajnë fushat mund të jetë:

1.1.3.1. **String/tekst**: simbole alfanumerike (shkronja dhe/ose numra).

1.1.3.2. **Integer**: numra të plotë pozitivë dhe negativë.

1.1.3.3. **Integer+**: numra të plotë pozitivë (duke përfshirë edhe zeron (0)).

1.1.3.4. **Decimal**: numra me pikë dhjetore, pozitivë apo negativë (vërejtje: pjesa decimale ndahet me pike (.) jo me presje (,). Shembull: 12.03, 3,2)

1.1.3.5. **Decimal+**: numra pozitivë me pikë dhjetore (duke përfshirë edhe zeron (0)).

1.1.3.6. **Datë**: datë në formatin yyyy-mm-dd, ku yyyy është viti, mm është muaji dhe dd është ditë.

1.1.3.7. **Enum**: element nga një listë e caktuar. P.sh. numër nga lista {1, 2, 3, 4, 5} ose shkronjë nga {A, B, C, E}.

1.1.4. Kushti

Tregon nëse fusha mund të lihet e zbrazët apo jo:

- 1.1.4.1. **E detyrueshme**: nënkupton që fusha përkatëse duhet të ketë vlerën e dhënë në mënyrë që ta bëjë fajllin e vlefshëm. Mosplotësimi i fushës së detyrueshme do të bëjë fajllin e pavlefshëm dhe të dhënat do të refuzohen nga sistemi.

1.1.4.2. E detyrueshme* (e detyrueshme me kusht): e detyrueshme në kushte të caktuara, p.sh.: e detyrueshme për persona fizik, por jo edhe për juridik.

1.1.4.3. Opsionale: nënkupton që fusha kërkon të ketë vlerën e dhënë mirëpo që mund të injorohet nëse e dhëna e caktuar nuk ekziston në aplikacionin e ofruesit të dhënave. Nëse ekziston informacioni atëherë konsiderohet e dëshirueshme që të plotësohet fusha opsionale, në mënyrë që të rritet cilësia e të dhënave të raportuara në raportin kreditor.

1.1.5. Përshkrimi

Përmban udhëzime të veçanta që duhet të ndiqen në lidhje me fushën përkatëse. Përshkruan fushën në rastet që është e nevojshme dhe siguron që ofruesi i të dhënave e kupton fushën dhe mund të ofrojë informacionin e kërkuar. Gjithashtu përmban opsionet specifike të dhënave për fushat përkatëse që duhet plotësuar.

2. Fajllat e pranueshëm

Në sistemin e RKK-së të dhënat mund të raportohen me anë të fajllave në formatin Text (Tab delimited) si dhe përmes web shërbimeve. Që fajlli të përpunohet me sukses, ai duhet të jetë në përputhje me strukturën e përshkruar në tabelat e mëposhtme.

3. Refuzimi i fajllave

3.1. Një rresht do të refuzohet gjatë përpunimit në sistem nëse:

3.1.1. Vlera që përmban fusha nuk është në përputhje me llojin e fushës. Psh nëse një fushë numerike përmban tekst;

3.1.2. Mosplotësimi me të dhëna i fushave të detyrueshme;

3.1.3. Fushat e caktuara nuk përmbajnë vlerat e caktuara sipas anekseve të përfshira në këtë dokument.

3.1.4. Rreshtat që përmbajnë gabime logjike. Disa mesazhe që shfaqen në këtë rast:

3.1.4.1. Shuma e aprovuar duhet të jetë më e madhe ose baras me shumën e disbursuar

3.1.4.2. Data e disbursimit nuk është në përputhje me intervalin e caktuar në sistem.

3.1.4.3. Data efektive nuk është në përputhje me intervalin e caktuar në sistem.

3.1.4.4. Nuk mund të lëshohet klasifikimi Likuiduar nëse shuma mbetur është më e madhe se zero.

3.1.4.5. Nuk lejohet përsëritja e klasifikimit të kredisë e cila është e raportuar me Writte off dhe shuma mbetur 0.00 paraprakisht.

3.1.4.6. Nëse vlera numerike nuk është në kuadër të limiteve të parafinuara.

Neni 3
Struktura e fajllave

1. Fajlli i kredive

Nr.	Emri	Tipi i të dhënave	Kushti	Përshkrimi
1.	Numri i kredisë	String (50)	E detyrueshme	Numri i kredisë në institucionin tuaj, duhet të jetë unik gjithmonë edhe në rastet kur kredia është e riprogramuar.
2.	Dega e institucionit financiar	Enum	E detyrueshme	Të plotësohet ID e degës së institucionit financiar ku lëshohet kredia.
3.	Lloji i kredimarrësit	Enum {0, ..., 3}	E detyrueshme	Statusi ligjor i kredimarrësit. Shiko Aneks I .
4.	Lloji i entitetit juridik	Enum {1, ... , 11}	E detyrueshme*	Të plotësohet nëse kolona 3 = 1 ose 3. Shiko Aneks II .
5.	Madhësia e entitetit juridik	Enum {XS,S,M,L}	E detyrueshme*	Të plotësohet nëse kolona 3 = 1 ose 3. Shiko Aneks XVI . Definimi i entiteteve juridike të bëhet sipas Udhëzuesit 02/2016, dokument i Ministrisë së Financave i cili është në mbështetje të nenit 17 të Ligjit Nr.04/L-014.
6.	Emri i kredimarrësit	String (150)	E detyrueshme	Emri i kredimarrësit për persona fizik si dhe Emri i biznesit për entitetet juridike.
7.	Emri i prindit	String (150)	Opsionale	Të plotësohet për personat fizik.
8.	Mbiemri i kredimarrësit	String (150)	E detyrueshme*	Të plotësohet nëse kolona 3 = 0 ose 2.
9.	Gjinia	Enum {M, F}	E detyrueshme*	Të plotësohet nëse kolona 3 = 0 ose 2. M = Mashkull F = Femër
10.	Numri personal i kredimarrësit / Numri unik identifikues i biznesit.	String (50)	E detyrueshme	Fusha do të validohet duke përdorur algoritmin e letërnjoftimit të Kosovës për personat fizik si dhe algoritmin e numrit unik identifikues të bizneseve të Kosovës për entitetet juridike. Për personat jo-rezidentë plotësohet numri i pasaportës.

11.	NIF (Numri i fermerit)	String (50)	Opsionale	Të plotësohet për kredimarrës fermer numër unik identifikues (NIF) për fermer.
12.	Data e lindjes / Regjistrimit	Date (YYYY-MM-DD)	E detyrueshme	Data e lindjes për personat fizik si dhe data e regjistrimit të biznesit për entitetet juridike. Formati i datës duhet të jetë (YYYY-MM-DD).
13.	Vendi i lindjes / Regjistrimit	String (100)	E detyrueshme	Vendi i lindjes së personave fizik bazuar në dokumentin identifikues si dhe vendi i regjistrimit të entitetit juridik bazuar në certifikatën e biznesit.
14.	Adresa	String (255)	E detyrueshme	Adresa e vendbanimit të personave fizik apo adresa zyrtare për entitetet juridike.
15.	Komuna	Enum	E detyrueshme*	Të plotësohet komuna për personat fizik rezidentë dhe entitetet juridike rezidente. Shiko <u>Aneks III</u> .
16.	Numri i telefonit	String (50)	E detyrueshme	Të plotësohet numri i telefonit të personave fizik dhe numri i telefonit të entiteteve juridike.
17.	Shteti	Enum	E detyrueshme	Shteti i qëndrimit / veprimit. Shiko <u>Aneks XV</u> .
18.	Adresa elektronike / Emaili	String (50)	Opsionale	Të plotësohet email adresa për personat fizik dhe email adresa e entiteteve juridike.
19.	Statusi martesor	Enum {1, 2, 3}	E detyrueshme	Të plotësohet për personat fizik. Shiko <u>Aneks IV</u> .
20.	Profesioni	Enum	E detyrueshme*	Të plotësohet profesioni për personat fizik. Shiko <u>Aneksi XXI</u> .
21.	Aktiviteti	Enum	E detyrueshme*	Të plotësohet aktiviteti për personat juridik.
22.	Lloji i Punëdhënësit	Enum {1,2}	E detyrueshme*	Të plotësohet lloji i punëdhënësit për personat fizik. Shiko <u>Aneks XX</u> .
23.	Bashkëhuamarrje me të ardhura	Enum {0,1}	E detyrueshme	Të plotësohet informata nëse kredia është bashkëhuamarrje me të ardhura. 1 – Po 0 – Jo
24.	Të ardhurat e bashkëkredimarrësit	Decimal +	E detyrueshme*	Të plotësohen të ardhurat për bashkëhuamarrësin (jo garantuesin) nëse kolona 23 = 1.
25.	Numri i anëtarëve të familjes	Integer+	E detyrueshme*	Të plotësohet detyrimisht për personat fizik për kredi marrësin.

26.	Të ardhurat neto të kredimarrësit në momentin e lejimit të kredisë	Decimal+	E detyrueshme	Të plotësohen të ardhurat mujore neto për personat fizik (paga neto) dhe të ardhurat neto vjetore (fitimi neto) për entitetet juridike sipas pasqyrave financiare të përgatitura sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), në pajtim me dispozitat e Ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, në momentin e lejimit të kredisë.
27.	Të ardhurat neto aktuale të kredimarrësit	Decimal+	E detyrueshme	Të plotësohen të ardhurat mujore neto për personat fizik (paga neto) dhe të ardhurat neto vjetore (fitimi neto) për entitetet juridike sipas pasqyrave financiare të përgatitura sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), në pajtim me dispozitat e Ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim. Këto shënime duhet të përditësohen sipas udhëzimeve të mëposhtme te fajlli i përditësimit të dhënave.
28.	Të ardhurat neto të kredimarrësit/bashkëkredimarrësit, në momentin e lejimit të kredisë	Decimal+	E detyrueshme*	Në rastet kur gjatë vlerësimit të aftësisë paguese të personave fizik janë marrë parasysh të ardhurat mujore neto edhe të bashkëkredimarrësit, atëherë të plotësohen të ardhurat mujore neto të kredimarrësit dhe bashkëkredimarrësit në momentin e lejimit të kredisë.
29.	Të ardhurat neto aktuale duke përfshirë edhe të ardhurat e bashkëkredimarrësit nëse aplikohet	Decimal+	E detyrueshme*	Në rastet kur gjatë vlerësimit të aftësisë paguese të personave fizik janë marrë parasysh të ardhurat mujore neto edhe të bashkëkredimarrësit, atëherë të plotësohen të ardhurat mujore neto aktuale të kredimarrësit dhe të bashkëkredimarrësit. Këto shënime duhet të përditësohen sipas udhëzimeve të mëposhtme te fajlli i përditësimit të dhënave.
30.	Treguesi i servisimit të borxhit ndaj të ardhurave mujore neto në momentin e lejimit të kredisë	Decimal+	E detyrueshme*	Të plotësohet raporti në mes të shumës së të gjitha kësteve mujore të kredive të kredimarrësit në të gjitha institucionet financiare në raport me të ardhurat mujore neto, në momentin e lejimit të kredisë. Në rastet kur gjatë vlerësimit të aftësisë paguese të personave fizik janë marrë parasysh të ardhurat mujore neto edhe të bashkëkredimarrësit, atëherë të merren parasysh total të ardhurat mujore neto të kredimarrësit dhe bashkëkredimarrësit gjatë kalkulimit të treguesit. Kjo fushë të plotësohet vetëm për personat fizik.

31.	Treguesi aktual i servisimit të borxhit ndaj të ardhurave mujore neto	Decimal+	E detyrueshme*	Të plotësohet raporti aktual në mes të shumës së të gjitha kësteve mujore të kredive të kredimarrësit në të gjitha institucionet financiare në raport me të ardhurat mujore neto. Në rastet kur gjatë vlerësimit të aftësisë paguese të personave fizik janë marrë parasysht të ardhurat mujore neto edhe të bashkë-kredimarrësit, atëherë të merren parasysht total të ardhurat mujore neto të kredimarrësit dhe bashkëkredimarrësit gjatë kalkulimit të treguesit aktual. Kjo fushë të plotësohet vetëm për personat fizik dhe të dhënat duhet të përditësohen sipas udhëzimeve të mëposhtme të fajlli i përditësimit të dhënave.
32.	Treguesi i borxhit të përgjithshëm të entitetit juridik në raport me Fitimin Para Interesit, Tatimit, Zhvlerësimit dhe Amortizimit (EBITDA), në momentin e lejimit të kredisë	Decimal+	E detyrueshme*	Të plotësohet raporti në mes të borxhit të tërësishëm të entitetit juridik në raport me fitimin para interesit, tatimit, zhvlerësimit dhe amortizimit (EBITDA), sipas pasqyrave financiare të përgatitura sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), në pajtim me dispozitat e Ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, në momentin e lejimit të kredisë.
33.	Treguesi aktual i borxhit të përgjithshëm të entitetit juridik në raport me Fitimin Para Interesit, Tatimit, Zhvlerësimit dhe Amortizimit (EBITDA).	Decimal+	E detyrueshme*	Të plotësohet raporti aktual në mes të borxhit të tërësishëm të entitetit juridik në raport me fitimin para interesit, tatimit, zhvlerësimit dhe amortizimit (EBITDA), sipas pasqyrave financiare të përgatitura sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), në pajtim me dispozitat e Ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim. Këto shënime duhet të përditësohen sipas udhëzimeve të mëposhtme të pjesa e përditësimit të dhënave.
34.	Spektori ekonomik	Enum	E detyrueshme*	Të plotësohet sektori ekonomik që i përket entiteti juridik sipas kategorive të përcaktuara në <u>Aneks V</u> .
35.	Lloji i kredisë	Enum {0, ... , 11}	E detyrueshme	Të plotësohet lloji i kredisë sipas kategorive të përcaktuara në <u>Aneks VI</u> .



36.	Periudha e kredisë	Enum {0, 1, 2}	E detyrueshme	Të plotësohet lloji i periudhës së kredisë. Shiko Aneks VII.
37.	Periudha e lejuar	Integer+	E detyrueshme	Të plotësohet kohëzgjatja e kredisë duke u bazuar në llojin e periudhës të zgjedhur në fushën 22 (Periudha e kredisë).
38.	Mënyra e pagesës së kredisë	Enum {1, ... , 9}	E detyrueshme	Të plotësohet mënyra e pagesës së kredisë sipas kategorive të përcaktuara në Aneks VIII.
39.	Urdhëresa e pagesës	Enum {0, 1}	Opsionale	Të plotësohet urdhëresa e pagesës sipas kushtit : 1 – Po 0 – Jo
40.	Shuma e aprovuar	Decimal+	E detyrueshme	Të plotësohet shuma e aprovuar e kredisë. Shuma e aprovuar nuk duhet të jetë më e vogël se shuma e disbursuar!
41.	Shuma e disbursuar	Decimal+	E detyrueshme	Të plotësohet shuma e disbursuar e kredisë.
42.	Data e aprovimit të kredisë	Date (YYYY-MM-DD)	E detyrueshme	Të plotësohet data e aprovimit të kredisë.
43.	Data e disbursimit të kredisë	Date (YYYY-MM-DD)	E detyrueshme	Të plotësohet data e disbursimit të mjeteve të kredisë.
44.	Data e maturimit të kredisë	Date (YYYY-MM-DD)	E detyrueshme	Të plotësohet data e maturimit të kredisë.
45.	Shuma e këstit	Decimal+	E detyrueshme*	Të plotësohet shuma e këstit të kredisë. Në rastet kur këstet nuk janë të rregullta, të plotësohet kësti mesatar. Kësti përmban shumën totale që klienti e paguan sipas planit të amortizimit (kryegjëja + interesi).
46.	Norma nominale e interesit	Decimal+ [0, 100]	E detyrueshme*	Të plotësohet norma nominale e interesit të kredisë si përqindje. Shembull: 10% shkruhet 10, 0.5% shkruhet 0.5.
47.	Norma efektive e interesit	Decimal+ [0, 100]	E detyrueshme*	Të plotësohet norma efektive e interesit të kredisë si përqindje. Shembull: 10% shkruhet 10, 0.5% shkruhet 0.5.
48.	Kosto totale e kredisë	Decimal+	E detyrueshme*	Kostoja totale e kredisë për klientin nënkupton të gjitha kostot, përfshirë interesin, komisionet, taksat dhe çdo lloj tjetër të shpenzimeve që banka i kërkon klientit ti paguaj, në lidhje me marrëveshjen/kontratën e kredisë; shpenzimet tjera të detyrueshme lidhur me marrëveshjen e kredisë, në veçanti premiumet e sigurimit janë të përfshira gjithashtu, po që se një kontratë e një shërbimi të

				tillë është e obligueshme për marrjen e kredisë, ose për marrjen e kredisë me kushtet e publikuara dhe nëse një shërbim i tillë paguhet nga banka dhe i ngarkohet klientit ose klientit nuk i ofrohet mundësia e përzgjedhjes së ofruesit të një shërbimi të tillë; Duke iu referuar “Rregullore Për Normën Efektive Të Interesit Dhe Kërkesat Për Shpalosje”- te plotësohet ne vlera.
49.	Kosto e disbursimit të kredisë	Decimal+	E detyrueshme*	Të plotësohen kostot e disbursimit të kredisë në vlerë.
50.	Shpenzimet tjera të kredisë	Decimal+	E detyrueshme*	Të plotësohen shpenzimet tjera të kredisë (psh.sigurimit...) të cilat nuk janë të përfshira në fushën 49.
51.	Valuta	Enum {1, 2}	E detyrueshme	Të plotësohet valuta e kredisë sipas kushtit: 1 – EUR 2 – USD
52.	Klasifikimi i kredisë	Enum {1, ..., 7}	E detyrueshme*	Të plotësohet klasifikimi i kredisë bazuar në nenin 5. të Udhëzimit të Regjistrisë të Kredive, sipas kategorive të përcaktuara në <u>Aneks IX</u> .
53.	Shtylla sipas SNRF 9	Enum {1, 2, 3}	E detyrueshme*	Të plotësohet nga bankat të cilat janë objekt i fushëveprimit të Rregullores për Aplikimin e Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar 9. Të plotësohet sipas kategorive të përcaktuara në <u>Aneks XIX</u> .
54.	Qëllimi i kredisë	Enum {1, ..., 8}	E detyrueshme	Të plotësohet qëllimi i kredisë sipas kategorive të përcaktuara në <u>Aneks X</u> .
55.	Qëllimi dytësor i kredisë	Enum {1, ..., 8}	Opsionale	Të plotësohet qëllimi dytësor i kredisë nëse ka sipas kategorive të përcaktuara ne <u>Aneks X</u> .
56.	Përdorimi i kolateralit	Enum {0, 1}	E detyrueshme	Të plotësohet përdorimi i kolateralit sipas kushtit: 1 – Po 0 – Jo
57.	Vlera e kolateralit	Decimal+	E detyrueshme	Të plotësohet shuma e kolateralit nëse fusha 56 = 1. Nëse fusha 56 = 0 të plotësohet 0.00. Kjo vlerë duhet të përputhet me totalin e kolateralit të regjistruar për kredinë.

58.	Raporti i kredisë ndaj Vlerës së kolateralit në momentin e lejimit të kredisë (LTV)	Decimal+	E detyrueshme*	Të plotësohet total ekspozimi bruto në nivel të kredimarrësit në raport me total kolateralin e paluajtshëm në momentin e lejimit të kredisë. Vlera e kolateralit të paluajtshëm duhet të bazohet në vlerën e tregut sipas kërkesave të Rregullores së BQK-së për Vlerësimin e Pasurive të Paluajtshme.
59.	Raporti aktual i kredisë ndaj Vlerës së kolateralit	Decimal+	E detyrueshme*	Të plotësohet vlera e tregut të kolateralit, në momentin e rivlerësimit, pas periudhës së lejimit të kredisë. Për pasuritë e paluajtshme, të plotësohet vlera e tregut të kolateralit sipas kërkesave të Rregullores së BQK-së për Vlerësimin e Pasurive të Paluajtshme.
60.	Kredi e ristrukturuar ose riprogramuar	Enum {0,1}	E detyrueshme	Të plotësohet nëse është kredi e ristrukturuar duke u bazuar në kërkesat e Rregullores për ekspozimet jo-performuese dhe ristrukturimet (Bankat) si dhe Rregulloren për Menaxhimin e Rrezikut Kreditor të IMFJB : 1 – Po 0 – Jo
61.	Numri i kredisë paraprake	String (50)	E detyrueshme*	Të plotësohet numri i kredisë paraprake nëse fusha 60 = 1.
62.	Historia e falimentimit	String (500)	Opsionale	Të plotësohet informata mbi falimentimin bazuar në vendimin e gjykatës.
63.	Komente	String (255)	Opsionale	Të plotësohen komentet lidhur me kredinë e klientit.
64.	Përkrahja nga Fondi	Enum {0, 1}	E detyrueshme	E detyrueshme për entitetet Fizik dhe Juridik. Të plotësohet nëse kredia është e mbuluar nga fondi për garanci kreditore. Nëse kredia nuk mbulohet nga fondi, shkruani 0 (zero). Shiko <u>Aneks XVII</u>
65.	Përqindja e përkrahjes nga fondi	Decimal+	E detyrueshme*	E detyrueshme për entitetet Fizik dhe Juridik. Të plotësohet norma e mbulimit të kredisë përmes fondit për garanci kreditore si përqindje. Vlerat korrekte duhet të jenë në intervalin (0, 100]. Nëse kredia nuk është e mbuluar nga fondi (fusha 48 është 0) atëherë të vendoset vlera 0.
66.	Numri unik i aplikacionit	String (50)	E detyrueshme	Numri unik i aplikacionit për institucionin tuaj.

2. Fajlli i personave të lidhur

Nr.	Emri	Tipi i të dhënave	Kushti	Përshkrimi
1.	Numri i kredisë	String (50)	E detyrueshme	Numri i kredisë në institucionin tuaj, duhet të jetë unik gjithmonë edhe në rastet kur kredia është e ri-programuar.
2.	Roli	Enum {1, ..., 5}	E detyrueshme	Të plotësohet roli i personave të lidhur me kredinë, sipas kategorive të përcaktuara në <u>Aneks XI</u> .
3.	Lloji i personit të lidhur	Enum {0, ..., 3}	E detyrueshme	Statusi ligjor i personit të lidhur. Shiko <u>Aneks I</u> .
4.	Pozita në entitetin juridik	String (50)	E detyrueshme*	Të plotësohet nëse kolona 3 = 1 ose 3. Për shembull drejtor, pronar...
5.	Emri i personit të lidhur	String (50)	E detyrueshme	Të plotësohet emri i personit të lidhur. Nëse kolona 3 = 1 ose 3 të plotësohet emri i pronarit ose i personit kontaktues.
6.	Mbiemri i personit të lidhur	String (50)	E detyrueshme	Të plotësohet mbiemri i personit të lidhur. Nëse kolona 3 = 1 ose 3 të plotësohet mbiemri i pronarit ose i personit kontaktues.
7.	Emri i entitetit juridik	String (100)	E detyrueshme*	Të plotësohet emri i entitetit juridik, kërkohet nëse kolona 3 = 1 ose 3.
8.	Numri personal	String (50)	E detyrueshme	Fusha do të validohet duke përdorur algoritmin e letërnjoftimit të Kosovës për personat fizik. Për personat jo-rezidentë plotësohet numri i pasaportës.
9.	Gjinia	Enum {M, F}	E detyrueshme	Për persona fizik dhe persona juridik të ndërlidhur.
10.	Numri unik identifikues i biznesit	String (50)	E detyrueshme*	Kërkohet nëse kolona 3 = 1 ose 3. Fusha do të validohet duke përdorur algoritmin e numrit unik identifikues të biznesit të Kosovës për entitetet juridike.
11.	Shteti	Enum	E detyrueshme*	Të plotësohet vendi i qëndrimit / veprimtimit vetëm nëse kolona 3 = 2 ose 3. Shiko <u>Aneks XV</u> .
12.	Data e lindjes / Regjistrimit	Date (YYYY-MM-DD)	E detyrueshme	Data e lindjes për personat fizik si dhe data e regjistrimit të biznesit për entitetet juridike. Formati i datës duhet të jetë (YYYY-MM-DD).

13.	Vendi i lindjes / Regjistrimit	String (50)	E detyrueshme	Vendi i lindjes së personave fizik bazuar në dokumentin identifikues si dhe vendi i regjistrimit të entitetit juridik bazuar në çertifikatën e biznesit.
14.	Adresa	String (255)	E detyrueshme	Adresa e vendbanimit të personave fizik apo adresa zyrtare për entitete juridike.
15.	Vendi	String (50)	E detyrueshme	Vendi i qëndrimit / veprimit.
16.	Komuna	Enum	E detyrueshme	Të plotësohet komuna për personat fizik rezidentë dhe entitete juridike rezidente (kolona 3 = 0 ose 1). Shiko <u>Aneks III</u> .
17.	Numri i telefonit	String (50)	E detyrueshme	Të plotësohet numri i telefonit të personave fizik dhe numri i telefonit të entiteteve juridike.
18.	Adresa elektronike / Emaili	String (50)	Opsionale	Të plotësohet email adresa për personat fizik dhe email adresa e entiteteve juridike.
19.	Data e lindjes së pronarit / personit të autorizuar	Datë (YYYY-MM-DD)	E detyrueshme*	Të plotësohet data e lindjes së pronarit apo personit të autorizuar nëse kolona 3 = 1 ose 3. Formati i datës duhet të jetë (YYYY-MM-DD).
20.	Vendi i lindjes së pronarit / personit të autorizuar	String (50)	E detyrueshme*	Të plotësohet vendi i lindjes së pronarit ose personit të autorizuar nëse kolona 3 = 1 ose 3.
21.	Gjinia e pronarit/personi i autorizuar.	Enum {M, F}	E detyrueshme*	Te plotësohet gjinia e pronarit/personit të autorizuar nëse kolona 3 = 1 ose 3.
22.	Përqindja e aksioneve	Decimal	E detyrueshme*	Te plotësohet përqindja e aksioneve të pronarit/es nëse kolona 3 = 1 ose 3.
23.	Adresa e pronarit / personit të autorizuar	String (255)	E detyrueshme*	Të plotësohet adresa e pronarit ose personit të autorizuar nëse kolona 3 = 1 ose 3.
24.	Vendi i pronarit / personit të autorizuar	String (50)	Opsionale	Të plotësohet vendi i pronarit ose personit të autorizuar nëse kolona 3 = 1 ose 3.
25.	Komuna e pronarit / personit të autorizuar	Enum	E detyrueshme*	Te plotësohet komuna e pronarit ose personit të autorizuar nëse shteti është XK (Kosovë).. Shiko <u>Aneks III</u> .
26.	Shteti i pronarit /personit të autorizuar	Enum	E detyrueshme*	Të plotësohet shteti i pronarit ose personit të autorizuar nëse kolona 3 = 1 ose 3. Shiko <u>Aneks XV</u> .

27.	Numri i telefonit të pronarit / personit të autorizuar	String (50)	E detyrueshme*	Të plotësohet numri i telefonit të pronarit ose personit të autorizuar nëse kolona 3 = 1 ose 3.
28.	E-mail adresa e pronarit / personit të autorizuar	String (100)	Opsionale	Të plotësohet e-mail adresa e pronarit ose personit të autorizuar nëse kolona 3 = 1 ose 3.

3. Fajlli i kolateralit

Nr.	Emri	Tipi i të dhënave	Kushti	Përshkrimi
1.	Numri i kredisë	String (50)	E detyrueshme	Numri i kredisë në institucionin tuaj, duhet të jetë unik gjithmonë edhe në rastet kur kredia është e riprogramuar.
2.	Numri personal / Numri unik identifikues i biznesit	String (50)	E detyrueshme	Fusha do të validohet duke përdorur algoritmin e letërnjoftimit të Kosovës për personat fizik si dhe algoritmin e numrit unik identifikues të bizneseve të Kosovës për entitetet juridike. Për personat jo-rezidentë plotësohet numri i pasaportës.
3.	Lloji i kolateralit	Enum {1, ..., 9}	E detyrueshme	Të plotësohet lloji i kolateralit sipas kategorive të përcaktuara në <u>Aneks XII</u> .
4.	Numri serik	String (100)	E detyrueshme*	Të plotësohet numri serik për kolateralin vetëm nëse kolona 3 = 1,2,3 ose 5. Për patundshmëritë të plotësohet numri i parcelës.
5.	Vlera e kolateralit	Decimal+	E detyrueshme	Të plotësohet vlera e tregut të kolateralit në momentin e lejimit të kredisë. Për pasuritë e paluajtshme, të plotësohet vlera e tregut të kolateralit sipas kërkesave të Rregullores së BQK-së për Vlerësimin e Pasurive të Paluajtshme.
6.	Vlera aktuale/rivleresuar e kolateralit	Decimal+	E detyrueshme	Të plotësohet vlera e tregut të kolateralit, në momentin e rivlerësimit, pas periudhës së lejimit të kredisë. Për pasuritë e



				paluajtshme, të plotësohet vlera e tregut të kolateralit sipas kërkesave të Rregullores së BQK-së për Vlerësimin e Pasurive të Paluajtshme. dhe të dhënat duhet të rifreskohen së paku në baza vjetore
7.	Vlera e shitjes së menjëhershme (diskontuar)	Decimal+	E detyrueshme	Të plotësohet vlera e shitjes së menjëhershme të kolateralit, në momentin e lejimit të kredisë.
8.	Vlera e kolateralit e pranuar nga banka, në momentin e lejimit të kredisë	Decimal+	E detyrueshme	Të plotësohet vlera e kolateralit të pranuar nga banka (pas diskontimit), në momentin e lejimit të kredisë.
9	Vlera aktuale e kolateralit e pranuar nga banka	Decimal+	E detyrueshme	Të plotësohet vlera e kolateralit të pranuar nga banka (pas diskontimit), në momentin e ri-vlerësimit, pas periudhës së lejimit të kredisë. dhe të dhënat duhet të rifreskohen së paku në baza vjetore
10.	Data e vlerësimit të fundit të kolateralit	Date	E detyrueshme	Të plotësohet data e fundit e vlerësimit të kolateralit të pranuar nga banka.
